

INFLUENZA AVIARE - MURTAJA KLASIKE E SHPENDËVE

GRIPI I SHPENDËVE



AUV- (agjencioni për ushqim dhe veterinar) KRYEN MBIKËQYRJEN E INFLUENCËS AVIARE (GRIPIT TË SHPENDËVE)

Më 1 dhjetor të vitit 2015 filloi realizimi i mbikëqyrjes zyrtare të sëmundjes murtaja klasike në shpendë dhe në shpendët e egra (influenca aviare, e njohur gjerësisht si gripi i shpendëve). Mbikëqyrja realizohet për të përcaktuar praninë e virusit të gripit të shpendëve në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Me mbikëqyrjen do të përfshihen popullacionet e mëposhtme në shënjestër:

- a) pularia që mbarësohet në prodhimtari komerciale (pulat vese, pulastrenët dhe shkurtat)
- b) pularia që mbarësohet në prodhimtari komerciale (shpendë në oborre dhe ekonomitë fshatare)
- c) shpendët e ujit që mbarësohet në oborre dhe ekonomitë fshatare dhe

- d) shpendët e egra që janë të pranishme ose migrojnë nëpër territorin e Republikës së Maqedonisë.

Mbikëqyrja realizohet në bashkëpunim me shoqatat veterinare që janë të obliguara të nxjerrin gjak nga pularia dhe marrje të shtupës nga shpendët e ujit, shoqatat e gjuetisë të cilët janë përgjegjës për marrjen e mostrave nga shpendët e egra ujore dhe veterinerët zyrtar përgjegjës për kontrollin e mbikëqyrjen.

Vërejtje: Mbarështuesit, shoqatat veterinare dhe shoqatat e gjuetisë janë të detyruar që t'i paraqesin derri te Agjencioni për ushqim dhe veterinari (veterinerët zyrtarë) rritjen e vdekshmërisë ose shfaqjen e shenjave klinike të sëmundjes në pulari ose shpendët e egra të ujit.

ÇFARË ËSHTË INFLUENCA AVIARE (GRIPI I SHPENDËVE)?

Influenca aviare është një sëmundje mjaft infektive virale e pularive dhe shpendëve të tjerë. Sëmundjen e shkakton virusi i gripit / influencës "A" nga familja *Orthomyxoviridae*, i cili mund të shkaktojë humbje të mëdha në industrinë e pularive, në mbarështimin e pularive dhe kufizimet në importin dhe eksportin e shpendëve të gjalla dhe prodhimeve nga shpendët.



Ekzistojnë shumë variacione të Influcencës Aviare dhe ata në përgjithësi mund të ndahen në dy kategori:

- influenza aviare me patogjenitet të ulët (LPAI - Low Pathogenic Avian Influenza) e cila zakonisht manifestohet me pak ose pa ndryshime klinike në shpendë dhe
- influenza aviare me patogjenitet të lartë (HPAI - Highly Pathogenic Avian Influenza), e cila shkakton ndryshime të rënda klinike dhe / ose vdekshmëri të lartë në zogj.

Influenca aviare është një sëmundje e shënuar në listën e sëmundjeve të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (OIE), e cila detyrimisht paraqitet, veçanërisht nënlojet, H5 dhe H7.

KUSH MUND TË INFEKTOHET ME INFLUENCËN AVIARE (GRIPIN E SHPENDËVE)?

Prej pularive më se shpeshti preken pulat dhe pulëdeti, ndërsa rosat dhe patat zhvillojnë vetëm simptoma të lehta. Shpendët e egër, veçanërisht rosat e egra mund natyrshëm të jenë rezistente ndaj sëmundjes dhe të mos tregojnë shenja klinike të sëmundjes. Shpendët që nuk tregojnë shenja të sëmundjes mundet ende ta bartin virusin dhe paraqesin rrezik nga përhapja e virusit në pulari.



Përderisa viruset e influencës aviare në përgjithësi janë lloje të viruse shumë specifike, nga virusi me patogjenitet të lartë H5N1 mund të infektohen edhe njerëzit. Virusi është izoluar edhe në gjitarë, duke përfshirë njerëzit, minjtë dhe minjtë e murrme, buklën, derrat, macet, tigrat dhe qentë.

Shtamet me patogjenitet të ulët të virusit të influencës aviare H5N1 ekzistojnë, por nuk shkaktojnë shenja të rëndësishme klinike në shpendë.

KU PARAQITET SËMUNDJA ?

Influenca aviare shfaqet në të gjithë botën dhe llojet e ndryshme të virusit janë të pranishme në zona të ndryshme të botës. Me interes të veçantë janë epidemitë e kësaj sëmundje të shkaktuara nga virusi me patogjenitet të lartë H5N1 që ndodhën në Azinë Jug-Lindore në fund të vitit 2003.

Gjatë disa viteve të kaluara, disa vende aziatike kanë raportuar epidemi, dhe në disa prej këtyre vendeve sëmundja tani llogaritet për prani endemike (gjithmonë e pranishme). Paraqitja e influencës aviare me patogjenitet të lartë ulët dhe Influenca aviare me patogjenitet të ulët gjithashtu janë paraqitur në Afrikë dhe Evropë. Vatrast e influencës aviare me patogjenitet të ulët në kontinentin Evropian janë paraqitur gjatë muajit nëntor të vitit 2014 në Gjermani, Holandë dhe Britani të Madhe.

SI NJIHET SËMUNDJA NË TUFË?

Influenca aviare përhapet jashtëzakonisht shpejtë në tufë, për një kohë të shkurtër sëmuren pothuajse të gjithë individët dhe shumë nga shpendët në tufë ngordhin brenda disa ditësh. Përhapja e sëmundjes në tufa që mbahen në kafaz është më e ngadalshme për shkak të kontaktit të kufizuar ndërmjet shpendëve.

Inkubacioni e sëmundjes është 3 deri 5 ditë



Shenjat e sëmundjes janë:

- Heshtje në tufë, mungesa e oreksit dhe depresion i skajshëm;
- Rënie e papritur dhe drastike në prodhimtarinë e vezëve, me pjelljen e vezëve të buta - ose vezë pa lëvozhgë;
- ënjtje dhe kongestion në lafshë dhe gushat në pularitë;
- ënjtje në lëkurë dhe nën sy,
- Kollitje, teshtitje dhe simptoma nervore;
- Diarre;
- Hemorragji në kyçin e thembrës.



Shkalla e vdekshmërisë mund të jetë 100% brenda 48 orëve.

Në formë të butë, shenjat e sëmundjes mund të shprehen si kreshpërimi i puplave, ulja e prodhimtarisë së vezëve, apo simptoma të butë të sistemit të frymëmarrjes.

Vërejtje: Nëse shpendët tuaja tregojnë ndonjë nga simptomat e kësaj sëmundjeje, ju duhet menjëherë të paraqiteni deri te shoqata veterinare më e afërt ose te veterineri zyrtar. Për mossuksesin dhe lëshimin duhet të njoftohen organet kompetente sepse kjo mund të ketë pasoja të mëdha për shëndetin e shpendëve dhe njerëzve.

SI PËRHAPET SËMUNDJA?

Virusi i influencës aviare mund të përhapet nëpërmjet kontaktit të drejtpërdrejtë me sekrecione nga shpendët e infektuara, sidomos me fekalet ose nëpërmjet ushqimit, ujit, pajisjeve dhe veshjeve të kontaminuar.



Shpendët e egra normalisht mund ta bartin virusin gripit të shpendëve në traktin e tyre të frymëmarrjes ose të zorrëve, pa u sëmurë. Shpendët e egra historikisht janë të njohura si rezervuar i virusit të Influcencës aviare, kryesisht prej shtameve me patogjenitet të ulët, andaj në nivel global zbatohen masat për mbikëqyrjen, përcjelljen, shfaqjen dhe karakteristikat e viruseve të Influcencës aviare në shpendët e egra, edhe pse shumica e këtyre viruseve nuk shkakton sëmundje.

Akoma nuk është e njohur roli i saktë i shpendëve të egra në përhapjen e virusit me patogjenitet të lartë të Influcencës aviare H5N1. Në përgjithësi, ekzistojnë shumë paqartësi për përfshirjen e shpendëve të egra, linjat migruese dhe mbi të gjitha, për mundësinë që disa lloje mund të bëhen rezervuar i përhershëm i virusit H5N1, pa treguar shenja klinike të sëmundjes.



Përveç kësaj që është e lartë infeksioni në mesin e shpendëve, viruset e Influcencës aviare transmetohen lehtë nga ferma në fermë nëpërmjet lëvizjes të shpendëve të gjalla shtëpiake, njerëzit mund ta transmetojnë sëmundjen me këpucët dhe veshjet e ndotura, automjetet, pajisjet, ushqimi dhe kafazet e ndotura.

Globalizimi dhe tregtia ndërkombëtare (legale dhe ilegale), panairët dhe tregjet e shpendëve, mënyra e mbajtjes së pularive dhe prania e virusit në shpendët e egra janë disa faktorë që kontribuojnë në përhapjen dhe transmetimin e Influcencës aviare.

SI DIAGNOSTIKOHET SËMUNDJA?

Influenca aviare mund të diagnostikohet në bazë të shenjave klinike dhe ngjarjeve që çojnë deri në sëmundje dhe me vërtetim laboratorik të mostrave që janë marrë për analizë.



ÇFARË ËSHTË RREZIKU SHËNDETËSOR NË NJERËZIT?

Sëmundja është zoonozë (sëmundje e cila prek kryesisht kafshët - shpendët, por shkakton sëmundje edhe te njerëzit).

Prej viruseve të Influcencës aviare në raste të rralla është e mundur që të infektohen njerëzit. Transmetimi në njerëz ndodh kur ekziston kontakt të afërt me shpendët e infektuara ose kur ata gjenden në mjedis shumë të kontaminuar.



Edhe pse Influenca aviare shkaktohet nga shtami me patogjenitet shumë të lartë nganjëherë mund të infektohet njeriu, sëmundja nuk duhet të ngatërrohet me gripit sezonal në njerëzit (zakonisht të shkaktuara nga H1 dhe H3 viruset).

Influenca aviare është një sëmundje që zhvillohet ushqim. Virusi i gripit të shpendëve shkatërrohet me temperaturë normale të gatimit. Nuk ekziston rrezik nga infeksioni me Influcencë aviare e mishit të gatuar si duhet nga pularia ose vezët.



Vërejtje: Pularia e sëmurë nuk duhet të hahet, sepse shpendët e sëmurë shpesh lirojnë helme dhe përmbajnë mikroorganizma të tjerë që mund të paraqesin rrezik për njerëzit.

CILËT KATEGORI TË NJERËZVE JANË EKSPOZUAR RREZIKUT?

Në grupin e rrezikuara bëjnë pjesë njerëzit që punojnë me pularitë (mbarështuesit, blerësit, transportuesit, punëtorët në thertore, veterinerët), të cilët vijnë në kontakt me materialin e infektuar nga shpendët, ose ato të përfshirë në kontrollin e sëmundjes. Gjuetarët dhe ornitologët janë ekspozuar në rrezik vetëm nëse ata vijnë në kontakt me kafshët e sëmura apo të ngordhura që kanë ngordhur nga virusi i Influençës aviare.



Vërejtje: Për shkak të potencialit të madh të virusit, rekomandohet njerëzit të cilët punojnë me ose të cilët janë në kontakt me shpendët për të cilat ekziston dyshimi se janë infektuar me Influncën aviare duhet të bartin rroba mbrojtëse personale e cila përfshin edhe maska për fytyrë, syze, doreza dhe çizme.

SI TË MBROHEMI?

Me rëndësi të veçantë është ekzistimi i sistemit të paraqitjes së hershme dhe zbulimit të hershëm të sëmundjes dhe kryerjen e masave parandaluese, si pjesë e strategjisë efektive për udhëheqje me Influncën aviare, të plotësuar me gatishmërinë potenciale për përgjigje në rast të shfaqjes së vatrës së sëmundjes.

Masat e mbikëqyrjes kanë për qëllim që të zbulohet prania e infeksionit në pular sipas standardeve të OIE për mbikëqyrje të Influncës aviare. Plotësuese janë programet për përcjelljen e paraqitjes, përhapjes dhe karakterizimit të viruseve të Influncës aviare të gjetura në shpendët e egra. Mbikëqyrja në shpendët e egra përfshin linjat të ndryshme migruese dhe sidomos vendet e grumbullimit ku përzihen shpendët shtegtarë nga kontinente të ndryshme.



Me rëndësi thelbësore është që mbarështuesit e pularive dhe shpendëve të mbajnë nivel të lartë të masave të biosigurisë në fermë për të parandaluar hyrjen e virusit në vet fermën.

MASAT PËR MBROJTJEN TË CILAT DUHET TË ZBATOHEN NË FERMË:

- pularia të mbahet më larg nga zonat që janë vizituar nga shpendët e egra,
- të kontrollohet qasja deri te fermat e shpendëve të njerëzve dhe pajisjeve,
- të eliminohen sende nga ferma të cilat mund t'i tërheqin shpendët e egra;
- mbajtja e higjienës në pronë dhe objektet ku mbahet pularia dhe pajisje
- të mos futen pulari / shpendë me status të panjohur sëmundjes në tufë/në fermë,
- të mbahet evidencë për shpendët e sëmura dhe të ngordhura.
- në mënyrë të përshtatshme të largohet plehu dhe pularia e ngordhur.



Nëse sëmundja konfirmohet në fermë, masa e cila detyrimisht të zbatohet në atë fermë është "vrasja" e pularisë-shpendëve me qëllim të çrrënjësjes së sëmundjes.

Në zbatimin e masës "vrasje" përfshihen edhe:

- mënyra humane e vrasjes së të gjitha kafshëve të infektuara dhe të ekspozuara;
- largimi i përshtatshëm i kufomave i të gjitha produkteve shtazore,
- mbikëqyrja dhe përcjellja e pularive potencialisht të infektuara ose pulari e ekspozuar ndaj sëmundjes,
- ndalimi për lëvizje dhe kontrolli i lëvizjes së shpendëve si dhe automjetet e rrezikshme,
- pastrimi i plotë dhe dezinfektimi i hapësirave të infektuara,
- sistemimi i sërishëm në femra të paktën pas 21 ditë.



Vrasja e shpendëve mund të plotësohet me vaksinimin e shpendëve në zonat me rrezik të lartë. Vaksinimi ka për qëllim që t'i mbrojë popullacionet e ndjeshme të shpendëve nga infeksionet e mundshme me çka e redukton shpeshtësinë ose peshën e sëmundjes. Vaksinimi me efikasitet mund të përdoret si masë emergjente në rast të shfaqjes së vatrës.

Çdo vendim i cili merret në drejtim të përdorimit të vaksinimit duhet të përfshihet në strategjinë për braktisjen e vaksinimit.